

ABSTRAKT

Ky punim i diplomës Master Juridik hulumton mundësinë e realizimit të të drejtave në asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore (në likuidim) jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës nuk ka qenë e pjesë e opinionit nr.9 të Komisionit të Badinterit, rrjedhimisht as pjesë e suksesimit (trashëgimisë) të ish-Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë. Kjo ka shkaktuar dëmtim të interesave të Kosovës në krahasim me anëtarët tjerë përbërës të federatës ish-jugosllave.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është e mandatuar me Ligjin e miratuar nga Republika e Kosovës, që përveç Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) dhe asetëve të tyre që gjenden brenda territorit të Republikës së Kosovës, të ushtroj autoritetin administrativ edhe ndaj asetëve të NSH-ve që gjenden jashtë territorit të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh vlerën dhe qasjen ndaj këtyre pronave dhe kufizimet e burimeve administrative të Agjencisë.

Asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore (në likuidim) që gjenden jashtë territorit të Republikës së Kosovës nuk janë duke u përdorur për të mirën e kreditorëve dhe pronarëve të këtyre ndërmarrjeve për shkak të vonesave dhe pengesave faktike gjatë ushtrimit të autoritetit administrativ të AKP-së. Vonesa në ushtrimin e autoritetit administrativ të AKP-së ndaj këtyre 163 asetëve e vonon edhe përmbylljen e procesit të likuidimit të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore (pronë e 39 Ndërmarrjeve Shoqërore që e kanë selinë në Kosovë).

Ky punim i diplomës Master Juridik dëshmon se është i mundshëm ushtrimi i autoritetit ndaj këtyre asetëve përmes bartjes së tyre në mirëbesim të Shteti i Kosovës dhe ndryshimeve ligjore përkatëse për transformimin e tyre pronësor, respektivisht realizimin e të drejtave në këto asete.

Rekomandimet kryesore të këtij punimi janë: 1) të përpilohet Plani i Veprimit ndër-institucional për të përgatitur ndryshimet ligjore përkatëse; 2) të bëhen ndryshime dhe plotësime të Ligjit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si dhe disa ligjeve tjera; 3) të përgatitet Ligj i posaçëm për ushtrimin e autoritetit administrativ ndaj këtyre asetëve; 4) të themelohet Komiteti Drejtues për administrimin e këtyre pronave; 5) të menaxhohen me kujdes: rreziku i pajtueshmërisë, rreziku i transakcioneve, rreziku strategjik, rreziku i menaxhimit dhe rreziku i reputacionit; dhe 6) të ketë raportime të rregullta para Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fjalët kyçe: asetet, privatizimi, heqja dorë e asetëve, mirëbesimi, likuidimi.

ABSTRACT

This master thesis in law researches the possibility of realisation of rights on Socially Owned Enterprises (in liquidation) outside of the territory of the Republic of Kosovo.

The Republic of Kosovo was not part of the Opinion no.9 of the Badinter Commission, therefore did not participate in succession of the former Federativ Socialist Republic of Yugoslavia. This has damaged the interest of Kosovo in comparison to other constituent members of the former Yugoslav federation.

Privatisation Agency of Kosovo is mandated with the law approved by the Assembly of the Republic of Kosovo, that apart from Socially Owned Enterprises (SOE) and their asset that are inside the territory of the Republic of Kosovo, to exercise the authority over the SOE assets that are located outside of the territory of the Republic of Kosovo, taking into consideration the value and the approach towards these assets and the limitations of administrative resources of the Agency.

The assets of the Socially Owned Enterprises (in liquidation) that are located outside of the territory of the Republic of Kosovo are not being used for the benefit of creditors and owners of these enterprises due to the delays and factual obstacle during the exercising of the administrative authority of the PAK. The delays in exercising the administrative authority of PAK toward these 163 assets delays the closure of the liquidation process of these SOEs (property of 39 SOEs that have the seat of registration in Kosovo).

This master thesis in law proves that it is possible to exercise the authority over these assets through transferring the same under the trusteeship of the State of Kosovo and the amendments of several laws to enable the property transformation, respectively the realisation of the rights over these assets.

Main recommendation of this thesis are: 1) to prepare the inter-institutional Action Plan to enable the amendments of the respective laws; 2) to prepare the amendments of Law on the Privatisation Agency of Kosovo and several other laws; 3) to prepare a special law to enable the exercise of the administrative authority over these assets; 4) the establishment of Steering Committee for administering these assets; 5) to carefully manage: compliance risk, transactions risk, strategic risk, management risk and reputation risk; and 6) to have regular reporting to the Assembly of the Republic of Kosovo.

Key words: assets, privatisation, disclaimer of assets, trust, liquidation.